REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E INSPEKTIMIT DHE MBROJTJES SË TERRITORIT
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

PROJEKT-VENDIM
Nr. 33, Date 26 / 05 /2025

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISE VENDORE TË VLERËSIMIT TË RISKUT NGA FATKEQËSITË NË BASHKINË DEVOLL

Në mbështetje të ligjit Nr 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, të Ligjit Nr .45/2019 "Për Mbrojtjen Civile". Vendimi Nr.531 datë 01.08.2003 ''Për organizimin,funksionimin,detyrat dhe përgjegjësitë e shërbimit të Emergjencave Civile'' Planit Kombëtar të Emergjencave Civile të miratuar me Vendimin Nr. 807, datë 28.12.2023 "Për miratimin e planit kombëtar për emergjencat civile"

PROPOZOJ:

1. Miratimin e strategjise vendore të vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në Bashkinë Devoll (bashkengjitur projekt-vendimit).
2. Për zbatimin e këtij projekt-vendimi ngarkohen te gjithe strukturat e Bashkise Devoll.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 neni 55, pika 6.

Konceptoi:
Për :Sektorin e emergjencave
Specialist : Y.Stena
Miratoi:
Drejtor : Marsel Mulla
Konfirmoi bazen ligjore: E. Avdo

KRYETARI I BASHKISË
EDUARD DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DEVOLL

Bashkia Devoll, Lagjia nr.1 Rr. 24 Tetori nr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288, E-mail bashkiadevoll@gmail.com.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E INSPEKTIMIT DHE MBROJTJES SË TERRITORIT
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 1688 **Prot.** **Bilisht, më** 13.05 **2025**

RELACION

Për Miratimin e Strategjise Vendore të Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë në Bashkinë Devoll

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Devoll.

Ne zbatim të Ligjit Nr.139/2015 "Për Veteqeverisjen Vendore" I ndryshuar ; Ligjit Nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", Vendim nr. 158, datë 17.3.2021 "Për miratimin e kritereve dhe të procedurave për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore".

Ju informojmë:

Strategjia vendore e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë ka të bëjë me zbatimin e politikave dhe strategjive për zvogëlimin e riskut të ftakeqësive,për të parandaluar riskun e ri,për të zvogëluar riskun ekzistues dhe për të menaxhuar riskun e mbetur,duke ndihmuar në forcimin e vetpërtëritjes dhe zvogëlimin e humbjeve në rast fatkeqësie.
Në këtë dokument bëhët një analizë për të përcaktuar natyrën dhe shkallën e riskut nëpërmjet analizës të risqeve të mundshme dhe vlerësimit të kushteve ekzistuese të ekspozimit dhe cënueshmërisë,që së bashku mund të dëmtonin njerëzit,pronën,shërbimet,jetesen dhe mjedisin e ekspozuar nga i cili ato varen.

Qëllimi kryesor është hartimi dhe miratimi i dokumenteve të vlerësimit të riskut për të mbështetur dhe lehtësuar punën e institucioneve qendrore dhe vendore në zhvillimin e një strategjie koherente dhe gjithëpërfshirëse për menaxhimin dhe zvogëlimin e riskut të fatkeqesive si dhe forcimin e të gjithë sistemit të mbrojtjes civile në vend.

Hartimi i tij synon të japë njohuri në shumë drejtime rreth proceseve të bashkëpunimit të aktoreve të ndryshëm vendor dhe kombëtarë,përfshirë dhe aktorët ndërkombëtarë ndërveprues në territorr në interes të mbrojtjes civile.

Në shkallë vendore vlerësimi i riskut përveç synimeve të mësipërme ka për qëllim dhe:

1.Uljen e pasigurive dhe paqartësive kundrejt riskut ne shkallë vendore.

2.Identifikimin e zonave specifike në fshatra dhe njësitë administrative me risk të larte dhe mbajtjen e tyre parasysh në dokumentin e strategjisë dhe në dokumentet e planikfikimit të territorit të Bashkisë.

3.Identifikimin e infrastukturave kritike në territorin e Bshkisë për të cilat është i domosdoshëm vlerësimi i riskut,gjetjet dhe përfundimet e të cilit duhet ti vihen në dispozicion autoriteteve vendore dhe qendrore.

Raportet e posaçme për secalin risk dhe raporti përmbledhës në krye të tyre janë hartuar në përputhje me ligjin nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile"dhe në aktet nënligjore,duke mbajtur parasysh edhe elemente të tjerë ndikues nga ligje të tjere që ndërlidhen me çështjen e mbrojtjes civile.

Konceptoi:
Për :Sektorin e emergjencave
Specialist : Y.STENA

Miratoi:
Drejtor : Marsel Mulla

KRYETARI
Eduard DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DEVOLL